



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 1362 Prot.

Tiranë, më 27.04.2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 3163/7 PROT., DATË 20.02.2026 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN PA NJË VENDIM
PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË
PARAQITUR NGA SHTETASI Z. ARMANDO LLESHAJ, LIDHUR ME
VEPRIMTARINË E PROKURORIT S.K.”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Armando Lleshaj, me nr. 3194 prot., datë 04.12.2024, në të cilën ngrihen pretendime për veprimtarinë e magjistratit S.K., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Lezhë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3163/7 prot., datë 20.02.2026, “Për përfundimin pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Armando Lleshaj, lidhur me veprimtarinë e prokurorit S.K.”, bazuar në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 122 të ligjit nr. 96/2015 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Lezhë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Përgega”, Ishull, Lezhë;

- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

